

**RRETH KOMPOZITAVE DHE TIPAREVE TË TYRE,
QËMTUAR NË MATERIALIN FOLKLORISTIK TË “BËLETËS
SHQYPTARE” TË THIMI MITKOS**

LONORA HYSOLLI

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Universiteti “ Fan S. Noli”

lhysolli@yahoo.com & lhysolli@unkorce.edu.al

Abstrakt: “Babai i folklorit shqiptar”, Thimi Mitko, me veprën e vet “Bëleta Shqyptare” u bëri një dhuratë të vyer gjithë brezave të studiuesve që priren të vënë në dukje vlerën e vërtetë të këtij burimi të pashtershëm shumëplanësh. Në pjesën e parë të kësaj vepre (vështruar tek “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912, II”, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1961), autori ka renditur gjithë çka munda të vjelë nga goja e popullit e të sistemojë me logjikën dhe dorën e vet: Fjalë të moçime; Fjalë t’errëta Të përshëndoshura; Emëra vetiakë; Këngë të vjetëra (alegorike dhe për të qeshur); Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara; Kënga shqype dasëmorie, Kënka shqype jaranishte; Gegërishte; Kënka shqype trimërishte; Këngë trimërie gegërishte; Përralla shqype.

Tek gjithë kjo lëndë, janë hulumtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash, të cilat, ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë inventari i kompozitave të qëmtuara është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë prodhimtare fjalëformimi, në këndvështrimin e lashtë dialektor burimor etj. Punimi rreket të sjellë mendim të argumentuar, që lidhet me vjetërsinë e kompozitave dhe rëndësinë që ato kanë për të vërtetuar se kjo mënyrë prodhimi fjalësh është po aq e vlerë dhe e lashtë për shqipen, sa dhe mënyrat e tjera dhe zhvillohet krahas tyre, sipas nevojave të leksikut të gjuhës. Materiali i vjelë prej veprës së Mitkos ka shumë rëndësi për të argumentuar idenë në fjalë, e “paragjykuar” disi nga disa studiues të huaj të shqipes.

Fjalë kyçe: fjalëformim, kompozita, kulturë kombëtare, personalitet, tipare, personalitet, veçori dialektore

ABOUT THE COMPOSITES AND THEIR FEATURES, FOUND IN THE FOLKLORIC MATERIAL IN "BËLETA SHQYPTARE" OF THIMI MITKO

Abstract: *“The father of albanian folklore”, Thimi Mitko, with his work “Bëleta Shqyptare” gave a precious gift to all generations of researchers who tend to notice the true value of this multiplan inexhaustible source. In the first part of this work, (looked at “Prime collectors of albanian folk 1635-1912, II”, The Institution of Folklor, Tirana, 1961), the author has listed everything he could collect from local people tells, depending on his own logic and handwriting:*

Ancient words; dark words; greeting words; proper noun; old songs (allegorical and funny); songs that are sang in special occasions; The albanian weddings song; The albanian love song; North; The albanian bravery song; The albanian northern bravery song; Northern bravery song; The albanian fairytale

In this whole subject, some compositions were searched up on, which like all non simple words, have characteristics and their own features. The entire inventory of composite nouns found and collected, is seen as an added value of albanian nation creation, efficient way of word formation, in the ancient point of dialect source etc.

The work tends to bring a argumentative opinion, which is related to the oldness of the composites and their importance to prove that this work creation way is as worth and acient for the albanian language as the other ways and develops alongside them, according to the needs of the language vocabulary. The acquired material taken from Mitko’s work, has much importance to argue the idea in question, “judged”, a bit by some foreign albanian researchers.

Keywords: *word formation, composition, international culture, personality, features, dialectical features.*

Hyrje

Është universaliteti dhe kompleksiteti i figurës intelektuale për ta vazhduar traditën përkujtimore në nder dhe respekt të mendimit e shpirtit të tij të mbrujtur me dashuri e krenari. Gjithmonë, ka diçka për të shtuar për të, pasi ai ka qenë, është edhe do të jetë... **Thimi Mitko.** Përkujtohet si folklorist, patriot, atdhetar, veprimtar i çështjes kombëtare, publicist, etj. Pra, përbën një personalitet të shquar të kulturës sonë kombëtare.

-**Si folklorist**, kreu një punë të sistemuar, mbështetur në kritere shkencore, për mbledhjen, ruajtjen dhe klasifikimin e materialit folklorik, duke u bërë kështu themeluesi i kërkimeve folkloristike. Ai qëmtoi me dashuri mes bashkatdhetarëve të tij në mërgim: këngët e bukura, lodrat zbavitëse, përrallat, gjuhën e kulluar të proverbave.

- **Si patriot e atdhetar**, evidenton rolin historik të krijimtarisë popullore për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare tek populli. Nxjerr në pah rëndësinë dhe rolin e madh që ka folklori tek gjuha dhe letërsia e një populli. Sipas tij, atdheu është i pari, është mbi të gjitha. Ai nuk e donte përçarjen fetare dhe copëtimin e Shqipërisë.

Testamenti dhe amaneti i tij “Bëleta Shqiptare”, duke qenë i qëllimshëm, si dëshmi e gjallë, zbulon më së miri ekzistencën e popullit shqiptar, jo thjesht si një shprehje gjeografike, por si një gjeni e madhe krijuese, me botë shpirtërore aq shumë të pasur, që përcillet në breza përmes këngëve, përrallave, gjëzave, proverbave etj... Për të, çështja e gjuhës amtare është po ashtu jetike, identitare, pasi është ushqim i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit... Përhapja e mësimi të gjuhës shqipe, prezantimi dinjitoz përballë botës së qytetëruar me traditat luftarake, me virtytet dhe aftësitë mendore të popullit shqiptar, e bëjnë Mitkon një rilindas të vërtetë.

Qëllimi

E kjo trajtesë gjuhësore le të jetë një pjesëz që e merr në konsideratë kontributin e tij gjuhësor, në sjelljen e fjalëve të përbëra të formuara në mënyrë origjinale si nevojë përditshmërie nga populli ynë, që në zanafillë. Babai i folklorit shqiptar, me veprën e vet “Bëleta Shqiptare” i bëri një dhuratë të vyer, thesar të paçmuar, vendit të lindjes, atdheut të tij dhe gjithë brezave të studiuesve që priren të vënë në dukje vlerën e vërtetë të këtij burimi të pashtershëm. Viti 1878 mbetet i shënuar në historinë shqiptare, sepse u botua ky testament, në përgjigje të kërkesave të kohës.

Nga Parathënia e Mitkos, mund të dallohet lehtë:

Qëllimi i “Bëletës Shqypëtare”, d.m.th i këtyre studimeve albanologjike, është përgjithësisht: shpëtimi dhe dhënia brezave që vinë i fjalëvet dhe tekstevet shqipe, të cilat para disa vjetësh i mbledha me shumë mundim e shpenzime, dhe besoj se do të kenë një vlefë, sepse në këto duket origjina, karakteri, zakonet e racës shqiptare; veçanërisht, dua që t’u ipet një shkak e një nxitje bashkatdhetarëve

shqiptarë për kulturën edhe për të studjuar gjuhën e tyre amtare, që me këtë mënyrë t'u sjell dobi që të mundin edhe këta të përparojnë edhe të kenë njësoj vleftë me vëllezërit e tjerë të tyre ellenofonë. Uroj që të tjerë, me të zotët se mua në këtë punë ta pasurojnë këtë mbledhje edhe ta zbukurojnë, që të përdoret për dobinë morale të kombit.

Metodologjia e përdorur

Në pjesën e parë të “ Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912, II” , Instituti i Folklorit, Tiranë, 1961, Thimi Mitko ka renditur çka mundi të vjelë nga goja e popullit dhe të sistemojë me logjikën dhe dorën e vet:

a. Fjalë të moçime ; b. Fjalë t'errëta ; c. Të përshëndoshura ; ç. Emëra vetiakë; d. Këngë të vjetëra (alegorike dhe për të qeshur); dh. Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara; e. Kënga shqype dasëmorie; ë. Kënka shqype jaranishte; f. Gegërishte; g. Kënka shqype trimërishte; gj. Këngë trimërie gegërishte; h. Përralla shqype.

Këtu janë qëmtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash të cilat, ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë inventari i kompozitave të qëmtuara, të cilat po i sjellim në punim sipas renditjes, është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë e lashtë ,prodhimtare fjalëformimi.

Rezultatet

a. Fjalë të moçime (f. 17-27)

Gjymës' e mijës *pesëqind*. I madh, *gjëmëmadhi*. Me njerin e vet ha e pi, pa *dhënëmarreje* mos ki. Puna është *faqebardhë* . Puno, o *fat-zi!* Hai o *bark-stihi!* Shpata e trimit edhe sofrë e *zëmërbardhit* nuku pritët kurrë. Vetëm një gomar *buzëbardhë?*

b. Fjalë t'errëta (f. 27-30)

Bythëkuqi rref *bythëzinë* . Dy shigjeta *pendëzeza*, tekdo i lëshon, atie venë.

c. Të përshëndoshura (f. 30-32) Faqebardhë

d. Këngë të vjetëra (35 këngë, f. 36-49)

shalë-dema , *krye-kaleshi*, *nuse-miri* , *derë-bardhi*

dh. Këngë që këndohen në disa ditë të caktuara (17 këngë, f. 50-55)
monobirrë, mirë-dita, kamë-bardhë, thumba-thumbuari, gozhdë-gozhduari

e. Kënka shqype dasëmore (58 këngë, f. 55-70)
këmbëkuqe, dhëndër-trimit, dhëndër-trimi, bash-hodë, faqe-zezënë, sy-zezë, faqe-qelqe, zëmbërë-ftohëtë, krahërgjëntë

ë. Kënga shqype jaranishte (73 këngë, f. 70-92)
lumëmadhëja, sy-larmenë/sy-larme, grykëzënë, sy-zezë, (përsëritur disa herë) vetullë-hollë, faqe-kuqesë, faqe-tolopuçeja, faqe-nkuqura, lesh-gjatë, lesh-kurore, mustaqe-zi, sy-zezat, dor'-argjënda, faqe-rrumbulla, mes-këputura, shami-kuqe, sy-rrushe, buzë-qengjërushëja, buzë-karafilëja, mes-langore, buzë-burbuqe, krahëruar-bardha, cullufe-zezë, (përsëritur disa herë), sy-konxhë, ballë-xhufetë, faqe-rrogosi, jelek-kuqeja

f. Gegërishte (5 këngë, f. 93-94) *mes-hollatë, vetull-qemere*

g. Kënka shqype trimërishte (93 këngë, f. 94-154)

- **Kënga e Gjikhë Thanasit nga Borshi i Haonisë**
murtajëmadhi, mustaqe ziu, derëzi, gunë-gjetë, binish-gjatë, papadhemoni, kordhë-shpata, qafë-gjati, fat-zinë, (përsëritur disa herë) faqe-bardhë, derë-ziu, mustaqezi, gunë-dhirë, pisqollë-artë, fustane-holli, vetullëhollë, fustane-bardhë, mustaqe-verdhë, bashnizamit, gjemenxhetë, pisqolle-larë, gushëbardhë, mëngëçarë, merhabanë, mustaqerruari, gunëbardhë, brigje -brigje, qafëzetas, Qafëzezi.
- **Kënga e kryengritjes së Gjon Lekës më 1847**
xhephanetë, mustaqeziu, shallvare-gjërë, kokë-mollë, kurris-dalë, kriso-gaitanë, kordhëshpata, myshaverenë, vetullëthanë, këmbë-pula, besë-qeni, vetullë-hollë, fat-keqe, mustaqe-dhiamë, dyfek-karafilë, besa e besë, mustaqverdhë.

gj. Këngë trimërie gegërishte (f. 155-165)

faqebardhë, krye-lopa, karadyzenë, mezil-dorinë, perçe-sërmalijetë, divanhane, kasaphane

h.Përralla shqype: Tinglimaimun

Te titujt e këngëve:

Mirë-dita për këllana; Lumeja ti mori *sy-zezë*; Moj unaza rreth flori; Tanana, moj *faqe-qelqe*;
Lumëmadheja ku je; *Syzezë, vetullë-hollë*; Vetë e bardhë *shami-kuqe*;
Tatushan moj *mes-langore*;
Ngjelino *buzë-burbuqe*; Moj *sy-zezë* moj *sy-konxhë*; Kardhiqotë *gunë-dhirë*; Bilbil o *pisqollë-larë*; O xhandar o *mëngëçarë*; More Nule *kurrisdalë*; *Pesëdhietë* kolonjarë duallë; *Pesëqind* dhen me pesë këmborë;

Çështja e fjalëve të përbëra të gjuhës shqipe është studiuar nga gjuhëtarë të mëdhenj të huaj, por dhe nga gjuhëtarë shqiptarë, të cilët, të tërhequr fort nga ndërtimi i fjalëve të kësaj gjuhe, **“të bekuar nga Perëndia”**, siç thotë Naimi, vendosën të japin ndihmesën e tyre në këtë drejtim. Studiuesi shqiptar i gjuhës Kostaq Cipo i ka përkufizuar kompozitat si *shprehje lakonike të rastit, miklime e lulëzime të gjuhës, që marrin nga një emër sipas punës që bëjnë në gjë të periodës*.

Një tjetër studiues shqiptar që i ka kushtuar vëmendje kompozitave është edhe Androkli Kostallari. Sipas tij, *fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në gjuhën shqipe është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintetike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të saj*.

Fjalët e përbëra dokumentohen që në monumentet më të lashta të gjuhës sonë të shkruar. Në veprat e Buzikut, Budit, Bardhit, Bogdanit, Varibobës e të tjerë takohen disa nga tipat më të vjetër e produktivë të kompozitave të shqipes. Në onomastikë dhe sidomos në toponomastikë gjejmë një dokumentim edhe më të lashtë të kompozitave në gjuhën e shkruar. Por, me gjithë këtë dokumentim të hershëm, pasqyrimi i kompozitave në gramatikën e shqipes është relativisht i vonë. Në studimin e tij kryesor mbi shqipen *Franc Boppi* nuk i trajton fare kompozitat e shqipes. Trajtimi i tyre, padyshim, do të ndihmonte shumë për të treguar edhe më qartë afërsinë e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane në lëmin e formimit të fjalëve dhe do ta bënte njëkohësisht më të plotë trajtimin e strukturës së fjalës në shqipen. Ky

qëndrim ndaj kompozitave të shqipes me sa duket, ushtroi një influencë të madhe mbi shumë studiues të mëvonshëm të shqipes, si p.sh. tek *Kamarda, Dozoni, Weigandi*, etj.

J.G.Hahn, punimet e të cilit janë në një kohë me ato të *F.Boppit*, edhe atëherë kur sjell si shembull mbiemrat e përbërë *derë bardhë, derë zi, kokë-lesh*, shpreh pikëpamjen se ky tip kompozitash është i rrallë në gjuhën shqipe . Fill pas *J. G. Hahnit* edhe *D. Kamarda* në shqyrtimin e kompozitave të shqipes niset gjithashtu edhe nga mendimi i gabuar se shqipja nuk është e pasur me kompozita të mirëfillta. Ai thotë shprehimisht se një gjë të tillë e ka vënë re edhe *Boppi*. *Kamarda* jep të dhëna të krahasueshme mbi formimin e fjalëve me anë të parashtesave, prapashtesave dhe kompozimit.

Gramatika , ku formimi i fjalëve në shqipe pasqyrohet më hollësisht se në çdo gramatikë tjetër të shekullit XIX, është ajo e *A. Dozonit*. Në këtë gramatikë kompozitat ndriçohen më pak se çdo mënyrë tjetër fjalëformuese. Sipas tij formimi i fjalëve në gjuhën shqipe, “*kryhet në radhë të parë me anë të derivacionit, ndërsa kompozimi është një fakt më i rrallë*”.

Ashtu si *A. Dozoni, G.Weigand* e konsideron kompozimin e fjalëve në shqipe si një shfaqje “shumë të rrallë”. Pastaj ai jep një pasqyrë mjaft të varfër të kompozitave të shqipes. Si kompozim të mirëfilltë dhe më të rëndësishëm në shqipen ai quan togfjalëshat tipit *emër në emërorë + emër në rrjedhore* si p.sh. *gur-mullini, breg-deti, vakt-dreke* etj.

Emrat më të dëgjuar shqiptarë në studimin e kompozitave janë ata të *Aleksandër Xhuvanit, Kostaq Cipos, Shaban Demirajt, Latif Mulakut, Androkli Kostallarit*, gjuhëtarë të cilët kanë bërë studime më të gjera e përgjithësuese për këtë tip fjalësh. Përmes këtyre studimeve është hedhur poshtë mendimi i mëparshëm, si një “paragjykim” i disa prej studiuesve kryesisht të huaj, si *Hahn, Dozon, Weigand* etj, sipas të cilëve gjuha shqipe nuk ka kompozita të mirëfillta dhe formimi i fjalëve të tilla nuk është karakteristike për të.

Në përgjithësi formantet kompozitëformuese të shqipes kanë këto veçori:

Rendi i përcaktuar i gjymtyrëve të kompozitës (sepse ndërrimi i rendit sjell prishjen e fjalës); Qënia e një theksi të vetëm kryesor për gjithë fjalën; Prania e zanores lidhëse (për një numër rastesh) e cila në këtë

rast luan rolin e një ndajshitese fjalëformuese, por shpesh edhe i vijës lidhëse, me të njëjtin efekt.

Si tipare të tyre veçojmë:

Duke patur të paktën dy tema motivuese, kompozitat kanë zakonisht një *ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura*. Temat përbërëse të kompozitave janë tema fjalësh emërtuese, që kanë një kuptim leksikor të qartë, të përcaktuar si : emra, mbiemra, folje, ndajfolje, por edhe numërorë apo përemra. Bazuar pikërisht tek raporti midis kuptimeve të gjymtyrëve dhe kuptimit të fjalës kompozitë, ne mund të përcaktojmë lidhjen sintaksore midis gjymtyrëve përbërëse (**bashkërenditëse/këpujore** apo **nënrenditëse / përcaktore**).

Kompozitat këpujore janë fjalë që përbëhen nga dy ose më shumë gjymtyrë me lidhje bashkërenditëse mes tyre: *kuqezi, shitblerje* etj. Ato plotësojnë në mënyrë të ndërsjelltë njëra-tjetrën. *Kompozitat përcaktore* janë fjalë të formuara prej dy gjymtyrësh që kanë lidhje nënrenditëse midis tyre, ku njëra përcakton tjetrën. (e para të dytën ose anasjelltas)

Diskutimi i rezultateve

Tek “ Bëleta” vihen re se kompozitat janë shumë e gjithfarësh:

1. Kompozita përcaktore: Vihet re se mbizotëron kompozimi me marrëdhënie nënrenditëse përcaktore mes gjymtyrëve të kompozitave: *Gjëmëmadhi, dhënëmmarrëje, faqebardhë, pendëzeza, krye-kaleshi, nuse-miri, këmbëkuqe, faqe-qelqe, zëmbërë-pula, zëmbërë-ftohëtë, krahërgjëntë, krye-lopa, sy-rrushe, mëngëçarë, besë-qeni, këmbë-pula, mustaqeverdhë, kurrisdalë* etj.

2. Kompozita këpujore: *Pesëqind, thumba-thumbuesi, gozhdë-gozhduari, pesëdhjetë, besa e besë, brigje- brigje.*

3. Nuk vihen re shkurtesa

Nga këndvështrimi burimor i krejt kompozitës apo elementeve të saj përbërëse, gjejmë këtu një grup kompozitash orientale, të cilat vijnë nga fusha të ndryshme semantike:

berberhane, divanhane, merhaba, sulltanevrüz, xhephane, kahreman, kasaphane, mejhane, perçe-sërmalijë, bashnizamit, karadyzenë

Ndër fjalët e përbëra, me *marrëdhënie përcaktore* midis njërës gjymtyrë me burim nga turqishtja dhe tjetrës me burim nga shqipja kemi:

binish-gjatë, palla-gjerë, shallvare-gjanë, sy-konxhë, vetull-qemere, dyfek-karafilë, pisqollëlarë, etj.

Kompozitat përcaktore me burim nga shqipja të të dyja gjymtyrëve, janë mbizotëruese:

Faqebardhë, buzë-bardhë, zemërbardhë, nuse-mirë, pendë-zeza, faqe-qelqe, krahargjentë, zëmbërë-ftohëtë, buzë-qengjërusherja, kokë-mollë, kurris-dalë, rreth-flori, vetullë-hollë etj.

Sipas Juliana Kumes (në *Çështje leksikore të gjuhës shqipe në fjalorin trigjuhësh të Thimi Mitkos, 2015: 119*), për formimin me anë të kompozimit:

*Të shumtë në numër janë emrat e kompozuar në krahasim me mbiemrat e kompozuar. Shumë prej këtyre emrave të kompozuar i krijon vetë autori, ose mund të jenë të asaj kohe të formuara nga rilindës të tjerë. Fjalët e përbëra që i hasim tek Mitkoja, sipas formimit të tyre janë bashkim i dy temave emërore ose emër + mbiemër. Nga dy tema emërore kemi strukturën morfematike **emër + emër + prapashtesa (sufiks)***

p.sh.: ujëdhësë-a (ujë/dhe/së-a), udhëkryq/e-ja (udhë/kryq/e-ja), uji-argjendi (uji/argjend/i), gur-argjendi (gur/argjend/i), shami-qafe-ja, këmishë-gjumi, rrobe-shtëpie, rrathëduarshet, cipë-gjarpëri, këmbë-pule-ja, shtëpizë-fushe, etj.

Emër + folje ose pjesore foljesh + prapashtesë (sufiks): *verëqitësi (verë/ qit/ ës/ i), lule-shtrydhëje (lule/ shtrydhë/ je), zemër-dashurë, bukë-shkelës-i (bukë/shkelës/i), lëkurë-rregjës-i, dorëshkrume-ja, gjellë-bërës, derë-hapuri-a, njeridashurë-i, zemër-dashur, gojë-lëshuarë etj.*

Emër + mbiemër + mbaresë: *lëvdatëmadh-i, lëvdatëkot-i; Zëmadh-i; sumadhe-ja; dritëshkurtërë-i; dhëmbëçalë-I; mëndie-hollë-i; shtat-mirë-i; gënjeshtërmadh;-i zemërmirë-i, sy-vëngër-i etj.*

Sa i takon çështjes së drejtshkrimit të kompozitave është mëse e pranueshme që të ketë shmangie, sa kohë që gjuha letrare shqipe ishte në fillimet e saj në prirjen drejt unifikimit e normëzimit. Në mënyrën e të shkruarit: Kompozitat e gjetura tek këngët e mbledhura të Mitkos, vijnë përgjithësisht të shkruara bashkë: *lumëmadhja, grykëzënë,*

murtajemadhi, gushëbardhë, mëngëçarë, kordhëshpata, vetullëhanë, kurrisdalë etj.

Por kemi dhe shkrimin me vizë në mes, që zënë vendin më të madh apo janë më të shumta në inventar si: *sy-larme, sy-zezë, lesh-gjatë, mes-langore, faqe-nkuqura, kordhë-shpata, gunëdhirë, besë-qeni, mustaqe-dhiamë, fat-keqe, shallvare-gjerë*, etj.

Edhe të shkruara ndaras, kemi kompozita si : *mustaqe ziu, brigje brigje, besa e besë, rreth flori (unaza)*

Në shumicën e përdorimeve, Thimi Mitkoja e ka regjistruar materialin duke u mbështetur kryesisht mbi të folmen e Korçës, Kolonjës, Përmetit, madje edhe të çamërishtes, ndoshta për shkak të përkatësisë së bashkatdhetarëve të tij në vendbanimin ku ai jetoi e punoi.

Si tipare të theksuara të toskërishtes vihen re:

Përdorimi i zanores **ë**- fundore: *sy-larmenë, grykëzënë, vetullë-hollë, faqe-kuqesë, mëngëçarë, vetullëthanë, faqezezënë* etj.

Përdorimi i zanores **ë**, në vend të zanores **e** të theksuar para bashkëtingëlloreve hundore m, n, nj: *dor'-argjenda, krahërgjëntë, zëmërbardhi*

Përdorimi i grupit **mb**: *zëmbrë-ftohëtë*,

Përdorimi i grupit **nt**, për **nd**: *krahërgjëntë*,

Ruajtja e zanores **e** tek trajta e shquar e emërores, për emrat e gjinisë femërore: *lumëmadheja, buzë-qengjëruseja, buzë-karafileja, jelek-kuqeja*

Përdorimi i **-s** fundore në vend të bashkëtingëllores **-z**: *kurris-dalë, faqe-rrogosi*

Ruajtja e grupit zanor **ua**: *krahëruar-bardha*

Përdorimi I bashkëtingëllores nistore **k** të shurdhët në vend të **g**-së së zëshme: *sy-konxhë* etj.

Përfundime

“Bletën” e tij, Mitkoja e botoi më 1879 me alfabetin e Kamardës me një qëllim shumë të lartë, siç shprehet ai: “*për të bashkuar muhamedanët e të krishterët shqiptarë edhe për të ndërtuar gjuhën tonë*”. Edhe këto fakte janë të mjafta për të arritur në përfundimin se Thimi Mitkoja vuri një gur të rëndë në ngritjen e ndërtesës së alfabetit të shqipes dhe njësimi të saj. Tek “Bleta”, janë qëmtuar e marrë në shqyrtim një sërë kompozitash, të cilat ashtu si gjithë fjalët jo të parme, kanë karakteristikat, tiparet dhe veçoritë e tyre. Gjithë

inventari i kompozitave të qëmtuara është parë si vlerë e shtuar e krijimit popullor, si mënyrë prodhimtare fjalëformimi, krahas mënyrave të tjera, të lashta sa vetë gjuha e popullit që e ka në folklorin e vet e që e trashëgon ndër breza.

Nuk mund të jetë rastësore që kompozitat me rrënjët (ose temat) e shqipes janë më të shumta. Madje, edhe kur huazon detyrimshëm nga ndikimi i gjuhëve në kontakt, rrënjën themelore e ka të vetën. Nëse jo, qëllimi justifikohet nga mjeti.

Fjalët e përbëra mbeten një nga çështjet më të diskutuara nga gjuhëtarët në rrjedhën e kohës, madje, siç thotë Aleksandër Xhuvani, kompozitat janë një nga çështjet e shumta të paharruara të gjuhës sonë. Me gjithë dokumentimin e hershëm kompozitat në gramatikat e gjuhës shqipe janë pasqyruar relativisht vonë. Midis trajtimit të kompozitave dhe brumit të gjallë leksikor të shqipes ekziston një lidhje mjaft e dobët. Kjo lidhje e dobët është shkaku kryesor i krijimit të një tradite gramatikore skeptike kundrejt kompozitave të gjuhës shqipe, traditë që në shfaqjet e saj ekstreme arrin deri në mohimin e plotë të ekzistencës së kompozitave të mirëfillta të shqipes. Shpesh në gramatikat e shekullit XX nuk është i qartë as vetë koncepti i fjalës së përbërë në gjuhën e sotme shqipe, por kompozitat janë një tip shumë i pasur dhe prodhimtar fjalësh edhe në gjuhën shqipe. Ato dëshmohen që me shkrimet e para të shqipes. Më herët ato dalin si emra vendesh, p.sh. *Gruemirë* apo mbiemra njerëzish p.sh. *Buzëglani* (*Buzëgjeri*). Krahas krijimit kolektiv për nevoja të bashkësisë folëse të shqiptarëve, fjalët e përbëra janë krijuar edhe nga dijetarë, shkrimtarë, intelektualë shqiptarë, në rrjedhë të kohërave. Kompozimi është *mënyra më prodhimtare fjalëformuese në gjuhën shqipe pas ndajshtesimit*.

Përpyekjet për krijimin e neologjizmave me kompozita me vetë brumin e gjuhës shqipe, qysh nga shkrimtarët e parë shqiptarë e duke vazhduar me shkrimtarët e Rilindjes, të kryesuar nga Naimi dhe Samiu e duke vijuar edhe në ditët e sotme, e ka mbështetur dhe Mitkoja me krijimet (fjalëformimet) e tij, duke parë si një nga rrugët më të rëndësishme të pasurimit të gjuhës me njësi, shprehje dhe ndërtime të reja, ashtu sikurse e shihte të lidhur ngushtë me detyrën e pastrimit të gjuhës nga njësitë leksikore, apo neologjizmat e panevojshme. Disa prej neologjizmave të krijuara me brumin e gjuhës shqipe nga autori ose që mund t'i kenë përkthyer asaj kohe, janë p.sh.: *dorëshkrume-ja*,

dheshkres, rrathduarshet, rrathë-duarset, rrobe-shtëpie, shami-qafeja, cipë-gjarpëri, erë-shtiellësa.

BIBLIOGRAFIA

- Baliu. B., *Thimi Mitko dhe fillimet e shkencës së Albanologjisë*, Korçë, 2015
- Demiraj. M.-Bushaj. M., *Rreth përdorimit të orientalizmave në veprën “Bleta Shqiptare” të Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- Haxhihasani. Q., *Thimi Mitko, Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti I Kulturës Popullore, Tiranë, 1981.
- Latifi. L., *Turqizmat dhe semantika e tyre në fjalorët e shqipes*, Tiranë, 2012
- Metani. I., *Identifikimi I krijimtarisë popullore sipas leksikut vendor në veprën e Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635- 1912, II”, Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961
- Mitko. Th., *Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1981.
- Shegani. K., *Vështrime leksikore në veprën e Thimi Mitkos*, Korçë, 2015
- Xhanari. L., *Korpusi i turqizmave në përmbledhjen folklorike “Bleta Shqiptare” të Thimi Mitkos dhe rëndësia e tij në përcaktimin e kronologjisë së hyrjes së turqizmave në gjuhën shqipe*, Korçë, 2015